



Data: 18.05.2018

Ref.: 490/KSD

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 55-të, të mbajtur më 10 Maj 2018, mori:

#### V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa nr.375/18 e datës 07.05.2018 e Kolegjit "Iliria". Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr. 684/17 i datës 11.08.2017.

#### Arsyetimi

Kolegji "Iliria" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim nr.375/18 e datës 07.05.2018 të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) nr.684/17 i datës 11.08.2017 në lidhje me heqjen e masës së suspendimit në programet e studimit të cekura në vendimin përkatës.


Pas shqyrtimit të kërkesës KSHC mori vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të Kolegjit "Iliria". KSHC konsideroi se gjendja faktike e Kolegjit "Iliria" në kohën e marrjes së vendimit të KSHC-së është trajtuar me saktësi nga KSHC në përputhje të plotë me UA për Akreditim i cili ka qenë në fuqi në momentin e marrjes së vendimit.

Duke pasur parasysh arsyet e cekura më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendim.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "Iliria"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

